



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



|   |                               |                               |                               |
|---|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Priljena/Pradato<br>Received/Delivery | 26.09.2023                    | 3                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Ijesta<br>Org./Unit                                  | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtyrja<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKPM/SHCK   | 6272                          | 2023                          | 114                           |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

A.nr.1072/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demianëtar, me Flakron Gashi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1072/2023 të datës 10.08.2023 të ankueses

kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 25.09.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1072/2023 e datës 10.08.2023 e parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Ministria e Punëve të Brendshme, me datë 15.06.2023 ka shpallur konkursin për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm" në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në të cilin konkurs kishte aplikuar edhe ankuesja e cila për shkak të pakënaqësive me procedurën e zhvilluar të rekrutimit me datë 10.08.2023 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) kishte parashtruar ankesën në Këshillin e pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses ka shkelur dispozitat e ligjit material, ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike pasi që e njëjta pretendon se ka ngarkuar në sistem Çertifikatën e Gjykatës për çështje penale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 15.08.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme me datë 22.08.2023 ka dërguar përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj lëndë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli: 5615/2023 e datës 10.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 21.07.2023 dërguar nga SIMBNJ për ankuesen; Çertifikatën e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër serik:D24C0D3B22F0468 e datës 02.08.2023; E-mailin e datës 03.08.2023 dërguar nga B.C për ankuesen; E-mailin e datës 02.08.2023 dërguar nga ankuesja për B.C; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.08.2023; Përgjigje në kërkesë e datës 22.08.2023; Konkursin e shpallur të datës 15.06.2023; Aplikacionin e ankueses të datës 21.07.2023; Çertifikatën me shifër Nr.2556 e datës 14.09.2004 lëshuar nga Fakulteti i Artëve në Universitetin e Prishtinës; Diplomë e datës 18.01.2018 me numër:154885; Diplomë e datës 18.01.2018 vulosur sipas interpretim gjyqësor; Shkresën e lëshuar nga Unviersiteti i Earshavës; Shkresën e datës 20.07.2023; Çertifikatën e PostEurop; Referencë e datës 03.02.2005; Vërtetimin e datës 21.07.2023; Vërtetimin e datës 21.07.2023 me numër reference:03-1769/23; Kopje e pasaportës së ankueses; Vërtetimin e datës 21.07.2023 me numër reference:03-1768/23; Letër motivimi i ankueses; Përgjigjen e datës 21.07.2023; E-mailin e datës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme përmes konkursit të datës 15.06.2023 ka shpallur konkursin-pranim, për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm" në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa sipas aplikacionit të datës 21.07.2023 konstatohet se kishe aplikuar edhe ankuesja [redacted] të cilës përmes e-mailit të datës 01.08.2023 dërguar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se e njëjta me rastin e aplikimit nuk kishte bashkangjitur çertifikatën e Gjykatës që nuk është e dënuar me vendim të formës të prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit, ashtu siç kërkohej në konkurs.

Ankuesja e pakënaqur me refuzimin e aplikacionit ka parashtruar kërkesë të brendshme me datë 01.08.2023, ndërsa Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP me datë 03.08.2023 e ka njoftuar ankuesen se dokumentacioni i dorëzuar pas afatit të aplikimit nuk pranohet, duke e udhëzuar të njëjtën me këshillën juridike se brenda afatit prej tetë (8) ditësh ka të drejtë ankesë pranë KPMSHCK-së.

Nga shkresat e lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme përmes konkursit të datës 15.06.2023 ka shpallur konkursin-pranim, për pozitën "Sekretar i Përgjithshëm" në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, kurse afati për aplikim në këtë konkurs ka qenë nga data 15.07.2023 deri me datë 22.07.2023, ndërsa ndër të tjera kërkesë e përgjithshme për pranim ka qenë: "Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje/Çertifikatë nga Gjykata që nuk

*është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit.*

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku neni 7 paragrafi 3 në paragrafi 3.3 kanë përcaktuar se: *“Së bashku me aplikacionin për konkurrim, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues në vijim: kopjet e dokumenteve që dëshmojnë plotësimin e kushteve për aplikim të kopjet e dokumenteve që dëshmojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion”* e që sipas parimeve të përgjithshëm të pranimit të përcaktuara me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik kërkohet që: *“Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje”* sikurse e njëjta dëshmi apo plotësim i kushteve të përgjithshëm të pranimit ishte kërkuar edhe për pozitën në të cilën kishte aplikuar ankuesja sipas konkursit të datës 15.06.2023, mirëpo e njëjta në ankesën e parashtruar në Këshill pretendimin e saj e mbështet me Çertifikatën e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me numër serik:D24C0D3B22F0468 të datës 02.08.2023 të cilën e ka ofruar në cilësi të provës, certifikatë kjo e cila është lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës përmes sistemit qendror të evidencës penale të Kosovës dhe mbi këtë bazë pretendimi ankimor i ankues del të jetë i pabazuar, ngase afati për aplikim në konkursin e kontestuar ka qenë prej datës 15.07.2023 deri me datë 22.07.2023 kurse ankueses certifikata në fjalë i është lëshuar pas kalimit të këtij afati respektivisht me datë 02.08.2023, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses është e pabazuar, ngase e njëjta certifikatën në fjalë e ka nxjerrë pas afatit kohor brenda së cilës ka qenë e parapara të bëhet aplikimi, gjegjësisht e njëjta nuk ka arritur ta mbështes me dëshmi aplikacionin e saj sikurse përcaktohet edhe me nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe nenin 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Prandaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi Kolegji i këshillit konstaton se me rastin e refuzimit të aplikacionit ankueses, Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit/DMZP ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 8 paragrafi 3 dhe 5 të Rregullores Nr. 01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, kurse ankesa e ankueses është e pabazuar për arsyet e dhëna sikurse në arsyetimin e këtij vendimi dhe mbi këtë bazë është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me numër A.nr.1072/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Eshref SHABANI  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Arkivitet të KPMSHCK-së

